

Financuar nga:



## NJOFTIM PËR EKSPERT STATISTICIEN

<b>Kontraktues:</b>	CBS Creative Business Solution
<b>Tipi i kontratës:</b>	Kontratë Shërbimi
<b>Kohëzgjatja:</b>	8 ditë pune ( <i>e shtrirë në 1.5 muaj</i> )
<b>Referenca e linjës buxhetit:</b>	6.2
<b>Data e publikimit:</b>	16.03.2018
<b>Afati i aplikimit:</b>	23.03.2018

### Informacion i përgjithshëm

Creative Business Solutions po zbaton projektin “*Monitorimi i Performancës së Bashkisë Dibër & Ndërgjegjësimi Komunitar për Pjesëmarrje*” i cili mbështetet në kuader të projektit PACT të financuar nga Bashkimi Evropian, Delegacioni në Shqipëri dhe zbatuar nga ANTTARC në partneritet me ALCDF dhe AfS. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në promovimin e qeverisjes së mirë, transparencën e shpenzimeve publike dhe pjesëmarrjen aktive të publikut në praktikën e ndershme dhe shpenzimet efikase publike në nivel lokal në Shqipëri. Projekti i cili është në fazë zbatimi, si pjesë të ndërhyrjes së tij parashikon “Veprime të integruara dhe Zhvillimin e një Ankete” në Bashkinë Peshkopi. Anketa synon të përcaktojë perceptimin publik, natyrën e të dhënave publike dhe format në të cilat është aktualisht i aksesueshëm; lehtësinë për të marrë informacionin si dhe tipologjinë/natyrën e informacionit mbi aktivitetin e bashkisë për të cilët banorët dhe segmenti i biznesit kanë interes.

### Qëllimi i Njoftimit dhe Përshkrimi i punës

Kjo kërkesë i drejtohet ekspertëve dhe/ose kompanive që mund të ofrojnë shërbime të kualifikuara të përpunimit statistikor të të dhënave. Eksperti i përzgjedhur duhet të ofrojë shërbime teknike të avancuara për analizën e pyetësorëve, procesimin dhe përpunimin e të dhënave dhe gjithashtu zhvillimin e një sistemi SPSS-i për hedhjen e të dhënave për çdo pyetësor ku secili anketues të zotërojë kredenciale personale. Sistemi do të shoqërohet me një manual përdorimi dhe trajnimin e nevojshëm për përdoruesit e sistemit. Në përfundim eksperti përpilon një raport final duke kombinuar përshkrimin narrativ dhe atë vizual të shoqëruar në formë grafike, tabelore dhe/ose diagramë. Eksperti i përzgjedhur do të duhet të kryejë disa udhëtime jashtë Tiranës.

Financuar nga:



### Kriteret e vlerësimit

Të gjitha aplikimet do të vlerësohen në mënyrë të barabartë dhe në fshehtësi të plotë. Kriteret e përzgjedhjes janë si më poshtë:

	%
<b>Kërkesa Teknike</b>	<b>80</b>
<b>Cilësia dhe eksperiencia e mëparshme</b>	20
Përvojë në përpunimin e të dhënave dhe dorëzimin e raportit final	25
Përvojë në zhvillimin e sistemeve SPSS	20
Kapaciteti për dorëzim në kohë	15
<b>Intervista përfundimtare</b>	<b>20</b>
<b>Totali</b>	<b>100</b>

### Mënyra e pagesës

100% pas zbatimit të suksesshëm të detyrave të paracaktuara dhe me dorëzimin e raportit final;

### Aplikimi

Kandidatët e kualifikuar dhe të interesuar duhet të dorëzojnë në e-mail [info@cbs.al](mailto:info@cbs.al) një CV të shoqëruar me një letër të shkurtër motivimi jo më vonë se data 23/03/2018, duke përfshirë "Ekspert Statisticien" në subjekt të e-mail. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen. Megjithatë, të gjithë aplikuesit do të marrin një përgjigje.

### Rreth CBS

Creative Business Solution, është një organizatë konsulence biznesi, jo fitim-prurëse me ekspertizë të theksuar në fushën e konsulencës financiare, financimin e sektorëve në zhvillim, asistencës teknike dhe zbatimin e projekteve zhvillimore me impakt të gjerë në zhvillimin ekonomik. Përmes veprimtarisë së saj CBS zbaton projekte komplekse në Shqipëri me ndikim edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. CBS ofron shërbime të vlefshme dhe efektive duke gjeneruar rritje ekonomike për bizneset, në sektorët e zhvillimit të ekonomisë, bujqësi, energji të pastër, turizëm etj. Ekipi i CBS numëron rreth 35 punonjës, të cilët operojnë në zyrat qendrore në Tiranë si dhe katër degë lokale në Fier, Korçë, Gjirokastrë dhe Peshkopi. CBS është partner zyrtar me USAID dhe ka marrëdhënie institucionale me organizata donatore ndërkombëtare. Gjithashtu, CBS ka bashkëpunim të ngushtë me bankat komerciale më të mëdha në vend dhe institucionet financiare, marrëdhënie aktive me mbi 400 SME dhe bashkëpunim me institucionet qeveritare.

Site zyrtar: [www.cbs.al](http://www.cbs.al)